



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2025

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI
SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RRIJTJEN E KAPACITETEVE TE QEVERISJES
VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES
VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)”**

Në mbështetje të nenit 2, pika 11, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.6, shkronja “b”, nenit 14 pika 5, neni 51 pika 4, nenit 54, shkronja “d” dhe “gj”, nenit 55 pikat 3, neni 64 shkronja “h”, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, dhe anëtarësimin e Bashkisë Përmet në SKP, të quajtur “Akademia e Trajnimit të Njësive të



Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi”.

TALGA do të ketë si mision zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi, me qëllim rritjen e performancës profesionale të tyre për t’i shërbyer cilësisht komuniteteve, për të përmbushur funksionet dhe kompetencat ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe për të përballuar me sukses sfidat e NJVV-ve në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kuadër të misionit të saj TALGA bën vlerësim të nevojave për trajnim, harton programe trajnimi dhe planin e trajnimeve, administron dhënjën e trajnimeve të vazhdueshme dhe të tjera, përcakton kriteret dhe bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnime, krijon rrjetet e zyrtarëve vendorë për shpërndarjen e njohurive dhe praktikave të mira, administron një platformë të menaxhimit dhe ndarjes së njohurive për zyrtarët e NJVV-ve dhe të interesuar në sektorin e qeverisjes vendore, harton dhe zbaton projekte dhe aktivitetet në fushën e veprimtarisë së TALGA, ofron ekspertizë dhe shërbime konsulence ndaj NJVV-ve, bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin emisionit të saj, kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve.

2. Dhënie e autorizimit për përfaqësimin e Bashkisë Përmet në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të marrëveshjes bashkëlidhur;
3. Të miratojë efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Përmet si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, dhe në shumën e përlllogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillin të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkatës së Asamblesë të Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimit dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Përmet të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 *“Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”* dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s.



Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Përmet të përfaqësojë Bashkinë Përmet në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Përmet nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë të TALGA.

6. Ngarkohet Kryetari Bashkisë, Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit, Sektorit Juridik e Prokurimeve, Drejtoria e Buxhet-Financë, Taksa Tregje për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

KRYETARI I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET
RELACION

“PËR

MIRATIMIN E PROJEKT-MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI
SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR RITJEN E
KAPACITETEVE TË QEVERISJES VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE
TË VETËQEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)”

Të nderuar Këshilltarë !

I. Qëllimi i projekt vendimit dhe objektivat që synohen të arrihen

Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ka përcaktuar funksionet e NJVV-ve dhe të drejtën dhe detyrimin për trajnimin e zyrtarëve (punonjësit dhe të zgjedhurit vendorë) në mënyrë që ato të ushtrjnë këto funksione sipas ligjit, standarteve, me efektivitet, efikasitet dhe në përputhje me strategjitë dhe prioritetet kombëtare, si dhe me standardet e BE-së. Në ligj parashikohet trajnim sistematik dhe buxhetor i stafit të NJVV-ve. Në këtë kuadër, kryetari i bashkisë duhet të marrë masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive (Neni 64/h), ndërkohë këshilltarët kanë të drejtën e formimit profesional, sipas një programi të miratuar nga këshilli bashkiak (Neni 51/4).

Ky projekt vendim ka si qëllim mundësimin e zhvillimit dhe kualifikimit profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të bashkisë.

Ky projekt vendim ka si objektiva:

- Krijimin e mundësive për ushtimin e përgjegjësive ligjore të këshillit bashkiak dhe të kryetarit të bashkisë për zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të këshillit të qarkut.
- Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030.
- Zbatimin e Dokumentit Kombëtar të Politikave dhe të Strategjisë për Administratën Publike.

aftësimin e zyrtarëve të bashkisë për të përballuar sfidat dhe kërkesat e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

- Krijimi i një strukture të dedikuar për aftësimin, kualifikimin profesional dhe trajnimin e zyrtarëve të bashkisë.

Nga pikëpamja organizimit dhe funksionimit, projektvendimi krijon premisat e nevojshme ligjore për krijimin e një personi juridik si subjekt të kompetencave të përbashkëta (SPK) në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.139/2015, neni 14 pika 5. Kështu, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Palët përcaktojnë ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave të SKP.

Ligji parashikon të drejtën për të krijuar person juridik dhe në linjë me parashikimet e Kodit Civil (nenet 24 dhe 26), personi juridik mund të jetë edhe shoqëri, shoqatë, fondacion dhe ent me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Nisur nga fakti që në këtë subjekt të kompetencave të përbashkëta angazhohen të ndërlidhen dhe ndërveprojnë nivele të ndryshme të qeverisjes (qendrore dhe vendore), propozohet të krijohet një Organizatë Jo-Fitimprurëse (OJF) në përputhje me Ligjin nr.8788/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve", ndryshuar. Ky opsion ka të njëjtën referencë ligjore si modeli i SHA-ve të Ujësjellës-Kanalizimeve, dhe ofron pavarësi në vendimmarrje dhe financim.

Kjo bazë ligjore mundëson krijimin e një OJF-je që garanton pavarësinë qeverisëse, funksionale, financiare dhe akademike, si dhe siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të saj, lejon fleksibilitet në mbledhjen dhe menaxhimin e fondeve nga burime të ndryshme përfshirë donatorët, ndërkohë që garanton përfshirje të barabartë të aktorëve të qeverisë qendrore dhe atyre vendore në qeverisjen, politikëbërjen, vendimmarrjen dhe financimin e saj.

II. Vlerësimi i projekt aktit në raport me politikat dhe prioritet e bashkisë dhe të Qeverisë së Shqipërisë.

Vetëqeverisja vendore është shtyllë themelore e funksionimit të një shoqërie demokratike dhe e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit, dhe garanton qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër me qytetarët. Suksesi i procesit të decentralizimit dhe i ushtrimit të autonomisë vendore varet, ndër të tjera, edhe nga cilësia e hartimit, zbatimit dhe moniorimit të politikave të bashkisë, cilësia e



shërbime të ofruara nga bashkia dhe aftësia e bashkisë për t'ju përgjigjur cilësisht nevojave dhe tendencave zhvillimore në nivel vendor, varen në një masë të madhe nga njohuritë, aftësitë, sjelljet dhe profesionalizimi i të zgjedhurive vendorë, i nëpunësve publikë të administratës së bashkisë si dhe i punonjësve të institucioneve, enteve dhe ndërmarrjeve në varësi të bashkisë.

Vetëqeverisja vendore në Shqipëri përballet me sfida të konsiderueshme në menaxhimin efektiv të burimeve, hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillimin e qëndrueshëm të territoreve dhe komuniteteve, si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. Procesi i decentralizimit të funksioneve tek bashkitë si dhe rritja e kërkesave për shërbime nga qytetarët dhe komunitetet e bëjnë të domosdoshme rifreskimin, përmirësimin dhe avancimin e njohurive dhe aftësive të zyrtarëve vendorë. Gjithashtu edhe politikat kombëtare për të modernizuar administratën publike si dhe për të digjitalizuar qeverisjen dhe shërbimet administrative, bëjnë të domosdoshme kualifikimin, profesionalizimin dhe modernizimin e administratës publike të NJVV-ve.

Trajnimet për zyrtarët e NJVV-ve janë ofruar nga subjekte të ndryshme shtetërore dhe në një masë të madhe nga programet e huaja të asistencës teknike, por këto trajnime kanë qenë sporadike, nuk kanë qenë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat konkrete të NJVV-ve. Trajnimet nuk janë ofruar për të gjitha funksionet e NJVV-ve, dhe për më tepër kanë lënë shpesh jashtë vëmendjes të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit jo-nëpunës civil të NJVV-ve. Trajnimet janë fokusuar kryesisht në përmbushjen e nevojave të përgjithshme horizontale, duke mos adresuar në mënyrë të gjerë dhe të thelluar temat vertikale që lidhen me funksionet dhe shërbimet specifike sektoriale të qeverisjes vendore. Për më tepër, nuk ka ekzistuar ndonjë proces i institucionalizuar dhe i rregullt konsultimi me zyrtarët e NJVV-ve për identifikimin e nevojave për trajnime apo për përmbajtjen e kurrikulave të trajnimit, veçanërisht ato sektoriale.

ASPAs dhe institucione të tjera shtetërore kanë ofruar një grup shërbimesh trajnimi për NJVV-të sipas parashikimeve ligjore, por ato mbeten të pamjaftueshme përkundrejt sfidave që NJVV-të përballen dhe pritjet që të përballen në kuadër të procesit të integritetit në BE.

Për pasojë, NJVV-të nuk kanë arritur të plotësojnë nevojat specifike të punonjësve të tyre, duke krijuar një hendek të madh në përmbushjen e kërkesave për trajnim dhe kjo ka sjell në pah nevojën për një qasje më strategjike dhe të integruar dhe një strukturë të qëndrueshme për zhvillimin e kapaciteteve dhe kualifikimin profesional të zyrtarëve të NJVV-ve, në mënyrë që ato të përmbushin kërkesat në rritje për shërbime cilësore të vetëqeverisjes vendore.

Numri i zyrtarëve të NJVV-ve ka ardhur në rritje, nga rreth 21,442 (2015), në rreth 32,000 (2021), 37,518 (2022), dhe rreth 39,000 (2023), ku të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit jashtë shërbimit civil përbëjnë shumicën e zyrtarëve të NJVV-ve, rreth 85% (*White Paper për Akademinë-2024*). Pavarësisht

rritjes së numrit të zyrtarëve të NJVV-ve, mbështetja financiare e NJVV-ve për trajnimet e tyre mbetet e ulët.

Por ndërkohë që numri i zyrtarëve të NJVV-ve dhe nevoja e tyre për trajnim ka ardhur në rritje, asnjë strukturë nuk ka pasur mandatin apo kapacitetin për të trajnuar në mënyrë të plotë, praktike dhe në kohën e duhur të zgjedhurit vendorë, nëpunësit civil dhe punonjësit e institucioneve e ndërmarrjeve në varësinë e NJVV-ve.

III. Koncepti, procesi, aktorët dhe modalitetet për ngritjen e Akademisë për Njësitë e Vetëqeverisjen Vendore.

Ngritja e Akademisë për Qeverisjen Vendore, si një strukturë të dedikuar për trajnim të zyrtarëve të NJVV-ve, përfaqëson realizimin e një nisme të kahershme dhe një kërkesë të artikuluar e lobuar prej vitesh nga NJVV-të, me synimin për të përmbushur nevojat e mëdha dhe në rritje për aftësimin dhe kualifikimin e të gjithë zyrtarëve të tyre.

Vizioni për të ngritur një strukturë të dedikuar për trajnimin e zyrtarëve të NJVV-ve u materializua në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimi dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 miratuar me VKM nr. 252, datë 20.4.2023, dhe u mbështet nga grupi ndër-institucional të punës të ngritur me urdhër të Kryeministrit (Janar 2023), dhe në takimet e të cilit morën pjesë morën pjesë aktive edhe shoqatat e NJVV-ve. Prosesi i diznejimit të Akademisë u mbështet me ekspertizë të huaj dhe vendase, të financuar nga Qeveria Svicerane dhe Qeveria Suedeze, u realizua në konsultim me kryetarë të bashkive dhe të këshillave bashkiakë të spektrit të ndryshëm politik si dhe me kryetarë të këshillave të qarqeve. Prosesi i diznejimit të Akademisë u realizua me përfshirjen e zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë dhe me praninë e zyrës së Komisionit Evropian në Tiranë dhe të donatorëve të tjerë. Për dizenjimin e Akademisë u morën parasysh 10 modele të shkollave dhe qendrave të trajnimit për administratën publike në Evropë dhe në rajon, si dhe modele të qendrave të trajnimit në Shqipëri. Ndërkohë, me shkresën nr. 532 prot., datë 18.09.2024 Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) ju drejtua 61 kryetarëve të bashkive, duke kërkuar konfirmimin për përfshirjen në buxhetin e vitit 2025 të kontributit financiar të secilës bashki për të mbështetur trajnimet e zyrtarëve të tyre përmes një strukture të dedikuar dhe në bazë të numrit të punonjësve të tyre.

Nga ana e NJVV-ve dhe në funksion të realizimit të iniciativës për ngritjen e Akademisë, Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës së Bashkive, me vendimin e saj të datës 04.09.2024, dakortësoi angazhimin e bashkive të Shqipërisë për mbështetjen e kësaj iniciative, si dhe për bashkëfinancimin e Akademisë në vlerën 50% të shpenzimeve operacionale dhe të trajnimeve.



Në vijim të këtyre iniciativave, Grupi Ndër-institucional i Punës miratoi Dokumentin e Politikës (Ëhite Paper) për Akademinë (Shtator 2024), dokument që më pas u miratua nga Këshilli Konsultativ Qeveri Qendrore - Qeveri Vendore (Dhjetor 2024).

Në përgjigje të angazhimit të Qeverisë së Shqipërisë për të mbështetur ngritjen e Akademisë si dhe të mbështetjes së shoqatave të NJVV-ve për ngritjen e Akademisë, këshillat bashkiakë konfirmuan njëzëri mbështetjen e tyre për nevojën e ngritjes së Akademisë, përmes miratimit të një fondi për trajnimet e zyrtarëve të bashkisë e që do t'i vihej në dispozicion Akademisë në momentin e regjistrimit të saj. Ky angazhim financiar përbën një shprehje e vullnetit të fortë të bashkive për ngritjen dhe financimin e Akademisë, si dhe përbën një element të rëndësishëm për avancimin e procesit të ngritjes së subjektit të kompetencave të përbashkëta (SKP).

Edhe Këshilli Bashkiak Përmet me Vendimin Nr.107 datë 18.12.2024 “ Për buxhetin e bashkisë viti 2025 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë institucioneve dhe njësive administrative në varësi të saj” miratoi fondin që do i vihej në dispozicion Akademisë.

Akademia që propozohet të ngrihet si personi juridik subjekt i kompetencave të përbashkëta, do të ofrojë një gamë të gjerë shërbimesh për të mbështetur dhe përmirësuar kapacitetet e NJVV-ve në Shqipëri duke përfshirë hartimin e kurrikulave dhe ofrimin e trajnimeve të specializuara, administrimin e platformës për menaxhimin dhe ndarjen e njohurive mes zyrtarëve të NJVV-ve, rrjetëzimin dhe bashkëpunimin mes tyre, ofrimi i ekspertizës dhe shërbimeve të konsulencës ndaj NJVV-të për zgjidhjen e problemeve dhe arritjen e objektivave në lidhje me zhvillimin e burimeve të tyre njerëzore.

Ngritja e Akademisë është thelbësore për t'i mundësuar NJVV-ve përballimin e sfidave për rritjen e cilësisë së jetës, zhvillim të qëndrueshëm të territorit dhe komuniteteve vendore si dhe sfidave që po sjell procesi i integritetit të Shqipërisë në BE. Vlerësohet se 70% e *acquis* zbatohet nga qeveritë vendore dhe rajonale dhe NJVV-të do të kenë një rol të rëndësishëm në këtë proces, dhe kjo është arsyeja pse niveli i njohurive dhe aftësive të zyrtarëve të NJVV-ve, për të përballuar këto procese, merr një rëndësi të veçantë.

Synohet që ofrimi i trajnimeve të përfshijnë tema specifike dhe sektoriale “vertikale” që lidhen me funksionet e NJVV-ve dhe me rreth 41 shërbimet e vetëqeverisjes vendore të tilla si Zhvillimi i Territorit, Infrastruktura dhe Shërbimet Publike, Shërbimet Sociale; Mbrojtja e Mjedisit; Bujqësia; Zhvillimi Rural; Pyjet dhe Kullotat Publike; Zhvillimi Ekonomik Vendor, Siguria Publike, etj. Programet e trajnimit do të hartohen bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnim, do të jenë paktike dhe dinamike, ndërkohë që hartimi i kurrikulave dhe dhënja e trajnimeve do të koordinohet me ASPA për të evituar mbivendosje të trajnimeve të ofruara.



Përfituesit kryesorë të shërbimeve janë nëpunësit civilë dhe punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi të NJVV-ve, si dhe të zgjedhurit vendorë, që përbëjnë rreth 39,000 persona. Kjo përfshirje e gjerë ndihmon në përmirësimin e performancës së qeverisjes vendore dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Nga pikëpamja organizimit dhe funksionimit, projektvendimi krijon premisat e nevojshme ligjore për krijimin e një personi juridik si subjekt të kompetencave të përbashkëta në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.139/2015, neni 14 (5). Kështu, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Për secilën palë përcaktohet ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave.

Ligji parashikon të drejtën për të krijuar person juridik dhe në linjë me parashikimet e Kodit Civil (nenet 24 dhe 26), personi juridik mund të jetë edhe shoqëri, shoqatë, fondacion dhe ent me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Nisur nga fakti që në këtë subjekt të kompetencave të përbashkëta angazhohen të ndërlidhen dhe ndërveprojnë nivele të ndryshme të qeverisjes (qendrore dhe vendore), propozohet të krijohet një Organizatë Jo-Fitimprurëse (OJF) në përputhje me Ligjin nr.8788/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve", ndryshuar. Ky opsion ka të njëjtën referencë ligjore si modeli i SHA-ve të Ujësjellës-Kanalizimeve, dhe ofron pavarësi në vendimmarrje dhe financim.

Kjo bazë ligjore mundëson krijimin e një OJF-je që garanton pavarësinë qeverisëse, funksionale, financiare dhe akademike, si dhe siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të saj, lejon fleksibilitet në mbledhjen dhe menaxhimin e fondeve nga burime të ndryshme përfshirë donatorët, ndërkohë që garanton përfshirje të barabartë të aktorëve të qeverisë qendrore dhe atyre vendore në qeverisjen, politikëbërjen, vendimmarrjen dhe financimin e saj.

Staregjia decentralizimit

Themelimi i OJF-së si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis qeverisjes qendrore dhe NJVV-ve, përmes aktit themelues dhe statutit, kërkon në të njëjtën kohë miratimin nga të gjithë këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarqeve të marrëveshjes për anëtarësimin në Akademi, SKP në formë OJF-je, si dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshje nga ministri përgjegjës për çështjet vendore sipas autorizimit të dhënë nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përmes VKM 405 dt.16.07.2025 "*Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me*



njesite e vetëqeverisjes vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të republikës së shqipërisë”. Sipas këtij vendimi, Këshilli i Ministrave ka marrë angazhimin të mbështesë financiarisht Akademinë përmes mbulimit të kostove fillestare të themelimit të saj si subjekt i kompetencave të përbashkëta, si dhe të financojë jo më pak se 50% të kostove operacionale të funksionimit të Akademisë për tri vitet e para të funksionimit për përmbushjen e objektivave të saj.

Hapi vijues në këtë proces është miratimi i marrëveshjes nga këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarqeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 139/2015, i ndryshuar. Pas përfundimit të këtij procesi të miratimit, do të vijohet me regjistrimin e personit juridik në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8788/2001, “Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve”, të ndryshuar.

IV. Propozimi për ngritjen e Akademisë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Për sa më sipër, dhe në mbështetje të nenit 2, pika 1, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.6, shkronja “b”, nenit 14 pika 5, nenit 54, shkronja “d” dhe “gj”, nenit 55, pikat 3, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”, i propozojmë Këshillit Bashkiak si më poshtë vijon:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP). në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi, të quajtur “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”.

TALGA do të ketë si mision zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi, me qëllim rritjen e performancës profesionale të tyre për t’i shërbyer cilësisht komuniteteve, për të përmbushur funksionet dhe kompetencat ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe për të përballuar me sukses sfidat e NJVV-ve në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kuadër të misionit të saj TALGA bën vlerësim të nevojave për trajnim, harton programe trajnimi dhe planet e trajnimeve, administron dhënjen e trajnimeve të vazhdueshme



dhe të tjera, përcakton kriteret dhe bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnime, krijon rrjetet e zyrtarëve vendorë për shpërndarjen e njohurive dhe praktikave të mira, administron një platformë të menaxhimit dhe ndarjes së njohurive për zyrtarët e NJVV-ve dhe të interesuar në sektorin e qeverisjes vendore, harton dhe zbaton projekte dhe aktivitetet në fushën e veprimtarisë së TALGA, ofron ekspertizë dhe shërbime konsulence ndaj NJVV-ve, bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin emisionit të saj, kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve

2. Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Përmet në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes bashkëlidhur;
3. Të miratojë efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Përmet si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, dhe në shumën e përlllogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillit të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkëtës së Asamblesë të Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimit dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Përmet të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 *“Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”* dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, bashkëlidhur këtij vendimmi, si dhe vendimeve të Asamblesë të TALGA--s;
5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë të përfaqësojë Bashkinë Përmet në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Përmet nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë të TALGA-s.

Konceptoi: K.Lile

Miratoi : L.Bushi



Sheshi “Abdyl Frashëri”, nr. 135581322254, e-mail: info@bashkiapermet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. ____ Date ____ / ____ / ____

PËR
MIRATIMIN E "STRATEGJISË VENDORE PËR ZVOGËLIMIN E RISKUT NGA
FATKEQËSITË" NË BASHKINË PËRMET.

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKB nr.30, datë 01.04.2025 "Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel vendor, bashkia Përmet", Urdhrin nr.155 datë 05.05.2025, "Për krijimin dhe funksionimin e Grupit Teknik të Punës në Bashki për hartimin e "Strategjisë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Planit Vendor për Emergjencat Civile" si dhe relacionin e paraqitur, me propozim të Kryetarit të Bashkisë :

VENDOSI:

1. Të miratojë Strategjinë Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë në bashkinë Bërmet.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha drejtoritë dhe strukturat e bashkisë Përmet..
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

RELACION

Për hartimin e dokumentit "Strategjia Vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë" në territorin e Bashkisë Përmet

Këshillit Bashkiak
Përmet

Qëllimi: Hartimi i dokumentit "Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë", në territorin e Bashkisë Përmet, sipas kërkesave të ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile".

Bashkia Përmet me qëllim hartimin e dokumentit "Strategjia Vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimt" sipas kërkesave të ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile", nxori Urdhrin nr 155 datë 05.05.2025, për krijimin dhe funksionimin e Grupit Teknik të Punës në Bashki për hartimin e "Strategjisë Vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Planit Vendor për Emergjencat Civile", me grupin teknik të punës që ngarkohej që të punonte për hartimin e këtij dokumenti.

Në hartimin e këtij dokumenti, Grupi Teknik në nivel bashkie për procesin e hartimit të Dokumenteve Strategjike për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, u kordinua me AKMC dhe dokumentave model sipas projektit të RESAL dhe UNDP të përgatitura për bashkitë e Qarkut Fier

U grumbullua gjithë informacioni i nevojshëm mbi risqet e mundshme nga përmbajtjet, tërmetet, zjarret në pyje, rrëshqitjet e tokës, ndotjet teknologjike dhe aksidentet industriale dhe risqet biologjike që mund të jenë prezente në territorin e Bashkisë Përmet.

U bë studim i gjithë zonave me risk të shtuar të fatkeqësive duke pyetur komunitetin e zonave të banimit, bizneset dhe grupet e interesit.

U zhvilluan takime me persona kyç dhe u plotësuan pyetësorë për të marrë të dhënat referencë për hartimin e strategjisë.

Grupi i punës, hartoi dokumentin e strategjisë bazuar në të dhënat e mbledhura dhe konsultimet e kryera.

Dokumenti reflekton kontributet e marra gjatë procesit të konsultimit dhe synon të përmirësojë aftësinë e bashkisë për të menaxhuar dhe zvogëluar risqet nga fatkeqësitë.

Dokumenti do të shërbejë si një udhërrefyes kyç për Planifikimin e Zhvillimit Urban, duke integruar masat për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive.

Ky integrim do të sigurojë që planifikimi urban dhe zhvillimi i bashkisë të marrë në konsideratë rreziqet natyrore dhe mjedisore, duke mbrojtur komunitetin dhe duke rritur qëndrueshmërinë e tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET



Ky dokument është themelor për përmirësimin e aftesisë së bashkisë për të menaxhuar risqet nga fatkeqësitë, për në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 45/2019, ai duhet të rishikohet dhe përmirësohet vazhdimisht, për t'u pershtatur me ndryshimet e mundshme në sfidat dhe rreziqet që mund të shfaqen.

Grupi Teknik vlereson se dokumenti "Strategjia Vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimt", është i përfunduar dhe përfaqëson një dokument cilësor që i paraqitet kësaj bashkie, ndaj mendojmë dhe kerkojmë miratimin e tij nga Keshilli I Bashkisë

Ju faleminderit!

Për Grupin Teknik të Punës
Florand Hasani





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

P/VENDIM

Nr. ____ datë ____ / ____ 2025

**PËR
MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË PËRMET PËR
VITIN 2025-2027**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“,Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit Nr.68/2017 «Për financat e vetqeverisjes vendore »; Ligjit Nr.10296 datë 08.07.2010 «Për menaxhimin financiar dhe kontrollin» i ndryshuar; Ligjit Nr.152/2013 «Për nënpunësin civil» i ndryshuar; Ligjit Nr.119/2014 «Për të drejtën e informimit »; Ligjit Nr.9367 datë 07.04.2025 «Për parandalimin e konflikteve të interesit në ushtrimin e funksionit shtetëror» ; Ligjit Nr.9154 datë 06.11.2003 «Për Arkivat»; Ligjit Nr.146/2014 «Për njoftimin dhe konsultimin me publikun»; Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Miratimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Përmet për vitin 2025-2027.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Përmet.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit në Prefekturë.

KRYETAR I BASHKISË

ALMA HOXHA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
PËR**

**MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË PËRMET
PËR VITIN 2025-2027**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 68/2017 «Për financat e vetëqeverisjes vendore»; Ligjit Nr. 10296 datë 08.07.2010 «Për menaxhimin financiar dhe kontrollin» i ndryshuar; Ligjit Nr. 152/2013 «Për nënpunësin civil» i ndryshuar; Ligjit Nr. 119/2014 «Për të drejtën e informimit»; Ligjit Nr. 9367 datë 07.04.2025 «Për parandalimin e konflikteve të interesit në ushtrimin e funksionit shtetëror»; Ligjit Nr. 9154 datë 06.11.2003 «Për Arkivat»; Ligjit Nr. 146/2014 «Për njoftimin dhe konsultimin me publikun»;

Plani i Integritetit 2022-2025 është miratuar me VKB Nr. 6 datë 30.01.2022. Ky Plan 3 vjeçar është hartuar në kuadër të projektit “Zgjerimi i praktikës standarde të planifikimit të integritetit në nivel vendor”, i financuar nga Projekti Star 3.

Gjatë vitit 2023, bashkia Përmet ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike në përmirësimin e kuadrit të brendshëm institucional, si dhe për aspekte të veçanta të integritetit, për rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit dhe sipas Raportit të Monitorimit të zbatimit të Planit në vitin 2023 ka rezultuar që Bashkia ka realizuar planin në masën 50%.

Raporti i monitorimit të zbatimit të planit të integritetit të bashkisë përmban një analizë të përgjithshme të zbatueshmërisë dhe progresit të vitit 2023, për aktivitete dhe masat të kuadrit riskut në fusha të veçanta të përgjegjësisë rregullator të performancës institucionale, si dhe për ti rezistuar shkeljeve të integritetit.

Linku i publikimit të Raportit <https://bashkiapermet.gov.al/plane-strategjike/>

Për sa më sipër me Urdhër të Kryetarit Nr. 310 datë 06.08.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e Planit të Integritetit 2022-2025 dhe hartimit të Planit të Integritetit 2025-2027”, Grupi i punës nisi me procesin e vetvlerësimit referuar një pyetësori me të dhëna, objektive të përcaktuara në Planin e mëparshëm si dhe plotësimin me informacion mbi treguesit gjinorë dhe social të Bashkisë Përmet.

Koordinatori i Grupit të punës Zv/Kryetari së bashku me Drejtorinë e Projekteve pas mbledhjes së informacionit, ka përpunuar të dhënat duke reflektuar objektivat me ndryshime në Plan.

Objektivat në planin e mëparshëm qëndrojnë ende si prioritet duke shtuar edhe Objektivin 4.

Më datë 18.08.2025 Grupi i punës organizoi dhe takimin e radhës për të diskutuar ndryshimet e bëra në Draft Planin e Integritetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Personi përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të planit të Integritetit është z.Florand Hasani me pozicion Nën Kryetar i Bashkisë Përmet, i cili ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Planit të Integritetit vecanërisht planin e veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit dhe të bëjë sugjerimet e nevojshme për përmirësimin e tij.

Të gjithë punonjësit e Bashkisë Përmet informojnë personin përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të planit në lidhje me gjendjen e integritetit të bashkisë, për veprime apo ngjarje që ndodhin dhe mund të cojnë në cënimin e integritetit të bashkisë.

Punonjësit e bashkisë , me kërkesë të personit përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të planit të Integritetit , duhet të dorëzojnë të dhëna dhe informacione që janë të nevojshme për zbatimin e planit të integritetit dhe të cilat nuk bien në kundërshtim me rregulloret në fuqi.

Të paktën një herë në vit, personi përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të planit të integritetit paraqet para Këshillit Bashkiak një raport mbi zbatimin e planit të Integritetit.

Drejtoria e Projekteve/ Integritetit Evropian/ Performancës dhe Dixhitalizimit të të dhënave
Klaudja Ciko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ARSIM,KULTURË,SPORT

Nr. _____ prot.

Përmet më _____.2025

P/VENDIM

Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmës ekonomike, deri në 6% .

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmen dhe shërbimet shoqerore “ i ndryshuar me VKM nr.868 dt.29.12.2021 “Per disa ndryshime ne Vendimin 597 dt.04.09.2019 të K.M.”Për percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmës ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese,mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike,VKM nr.85 dt.10.02.2021,nr.617,date 22.09.2022 i perditesuar: Vendimin e Keshillit Bashkiak Permet me fondet e Buxhetit Vendor.VKB nr.107 date 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2025 dhe percaktimin e numrit te punojseve të bashkise, institucioneve në varesi të saj”. Keshilli Bashkiak,me propozim të Kryetares së Bashkisë:

VENDOSI

- 1.Të perfitojnë ndihme ekonomike per Muajn Korrik **2025**, 6 familje me një fond prej **21.184 lekë**.
2. Familjet që perfitojne jane si më poshtë:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma
1	Ylli Guçe Pelushaj	Zylkade Qerim Pelushaj	2	3.703
2	Roland Petraq Jorgji	Divorcuar	1	2.178
3	Lame Enver Ferati	Silvana Kujtim Ferati	3	5.227
4	Mimoza Skënder Gjoka	Divorcuar	1	2.178
5	Lefteri Mihal Tyto	Divorcuar	1	5.720
6	Flavia Musa Pelushaj	Beqare	1	2.178
	SHUMA			21.184

- 3..Ngarkohen per zbatimin e ketij vendimi sektori buxhet-finance dhe zyra e ndihmes ekonomike.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ARSIM,KULTURË,SPORT**

Nr. _____ prot.

Përmet më _____._____.2025

RELACION

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK NDIHMËS
EKONOMIKE, DERI NË 6% .**

Mbështetur në Ligjin Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”Ligjit 935datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”I ndryshuar me VKM Nr.955 datë 07.12.2016(kreu II pika 13)dhe udhëzimi nr.5 datë 17.02.2017 pika 2 i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.Për përcaktimin kriterëve,dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike si dhe VKM nr.85 dat10.02.2021,nr.868,datë 29.12.2021;nr.617,datë 22.09.2022 i përditësuar Vendimi i,Këshillit Bashkiak Përmet me fonde të Buxhetit Vendor Nr.107 datë 18.02.2024”Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë,institucioneve në varësi të saj “Këshilli Bashkiak ka të drejtë të trajtojë me ndihmë ekonomike familjet aplikuese që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,deri 6% të bllok ndihmës ekonomike të muajit.Korrik 2025 me Vendim të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Socail Gjirokastër.Nr.10/2022 datë 27/10/2022 për dhënien e NE për periudhën 01-31-2025 Për Bashkinë Përmet.(Sipas vendimit të Muajit Korrik 2025).

Për sa më sipër vlera e fondit të kushtëzuar (bllok ndihma ekonomike) për Muajin Korrik 2025

është 51 familje me,Shumën prej 366.744 lekë dhe për tu trajtuar familje me ndihmë ekonomike janë në dispozicion 6% e këtij fondi ose 22.005 lekë,për Muajin Korrik 2025.

Mbështetur në të dhënat për dhënien e Ndhmës Ekonomike për periudhën 1-31 Korrik 2025 kanë aplikuar 6 familje nuk ka dale as nje fituese 50 janë përfituese në skemën e Ndhmës Ekonomike.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikuesve që nuk kane marë pikët e mjaftueshme për periudhën 01Korrik deri më datën 31 nga vlersimi I SH.S.SH rekomandojmë:

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar prej 6%,6 familje me një vlerë 21.184 lekë,nga ku fondi 6% në total sipas vendimit është në Shumën 22.005 diferenca prej 821 lekë do të mbetet e papërdorur për muajin Korrik.Trajtohen dy individë me statusin jetimë. me 19.800 lekë,nga 9.900 lekë sejcili.

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
DREJTORIA E SHËRBMIT SOCIAL
ARSIM,KULTURË,SPORT

Nr. _____ prot.

Përmet më _____._____.2025

P/VENDIM

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI
GUSHT 2025**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore"i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore "i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM Nr 868 date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike",VKM Nr617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597,date 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave,"Për përcaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore,të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.107 datë 18.12.2024 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2025 dhe percaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj "Keshilli Bashkiak me propozim te Kryetarit te Bashkise:

VENDOSI

1.Të përfitojne ndihme ekonomike për Muajn **GUSHT 2025**, **33** familje me një fond **123.500 lekë**.

2.Fondet të përballohen nga struktura :

1.Gr.00.Tit.AC135.Kap.05.Art.606.Kod produkti V043AAD per shumen 123.500 lekë

3. Familjet që përfitojnë janë si më poshtë:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma/leke
1	Ziso Apostol Kristo	Valentina Polikron Kristo	3	4200
2	Xhilda Xhemal Selimllari	Xhilda Xhemal Selimllari	2	3600
3	Mitro Gani Zeqiri	Lefteri Rrapi Zeqiri	4	4700
4	Syrja Mehmet Hoxha	Beqar	1	3200
5	Drita Irakli Kosta	Divorcuar	2	3600
6	Lefteri Polikron Proko	E ve	1	3200
7	Andon Dhimitraq Kukureci	I ve	2	3600
8	Aferdita Nuredin Lahe	Beqare	1	3200
9	Arben Thoma Teka	Mirela Xheli Teka	6	5400
10	Viktor Josif Proko	Divorcuar	1	3200
11	Dhimo Naun Dimçi	Lindita Hysen Dimçi	3	4200
12	Vera Thanasi Nage	E ve	2	3600

13	Leonart Petro Markaj	Kristina Petraq Markaj	3	4200
14	Thoma Aristidh Ilia	Maria Nuredin Ilia	4	4700
15	Xhensila Maksim Jahaj	Beqare me Femijë	2	3600
16	Violeta Guce Pelushi	Beqare	1	3200
17	Engjellushe Manxho Canollari	E ve	1	3200
18	Rivelino Fatmir Doko	Hurma Leonidha Doko	4	4700
19	Bajame Fari Hysenshahaj	E ve	1	3200
20	Lida Koco Thomollari	Divorcuar	1	3200
21	Vasilika Bedri Malka	E ve	2	3600
22	Ilir Sali Jashari	Beqar	1	3200
23	Vitori Llazo Caci	Beqare	2	3600
24	Luam Ferit Zeneli	Gezime Tafil Zeneli	4	4700
25	Ilber Kudret Dalipaj	Divorcuar	1	3200
26	Kastriot Kristo Koto	Kastriot Kristo Koto	3	4200
27	Kastriot Astrit Male	Divorcuar	1	3200
28	Vangjush Thanas Mamillo	Gentiana Seit Mamillo	3	4200
29	Bari Avni Zaimi	Valbona Zenel Zaimi	2	3600
30	Kadri Petrit Maska	Beqar	1	3200
31	Dashnor Guçe Pelushaj	Vezire Ali Pelushaj	4	4700
32	Klodiana Kristofor Peçi	Divorcuar	1	3200
33	Lulëzim Barjam Beqari	Divorcuar	1	3200
	SHUMA			123.500

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Tatim –Taksa/Spektori i Buxhet Financës.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë mbas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
DREJTORIA E SHËRBMIMIT SOCIAL
ARSIM,KULTURE,SPORT

Nr. _____ prot.

Përmet më _____._____.2025

RELACION

PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI GUSHT 2025

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore"i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë.20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"i ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore "i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM Nr 868 date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike",VKM Nr.617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597,date 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave,"Për përcaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore,të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.107 datë 18.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punojësve të bashkisë, institucioneve në varësi të saj.Familje të cilat janë përfituese në fondin e bashkisë janë ato familje të cilat mbasi kanë bërë aplikimin në Sistemin e Ndihmës ekonomike, rekomandimin në fondin 6% nuk janë fituese. Dhe nga vizitat e kryera në familje nga Administratorët shoqëror duke parë gjëndjen ekonomike të këtyre familjeve të cilat janë në gjëndje të dobët ekonomike u arsyetua që të përfshihen në fondin e familjeve në nevojë.

Përsa më sipër rekomandojmë të ndihmohen për muajin Gusht 33 familje me një vlerë prej 123.500 lekë.

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr _____ Prot

Datë _____._____.2025

Për

**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË PËR DHËNIE
NDIHME FINANCIARE**

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ” ,Ligjin Nr. 68 /2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore ”,Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar,Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar , Ligji Nr.115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”, Vendimi i KB Nr.107 datë 18.12.2024 “Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2025” dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj” ,Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

V E N D O S I

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë për shpenzime buxhetore të paplanifikuara (për dhënie ndihme financiare) në masën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. për sa më poshtë vijon:

1.	Azis Ismaili	në shumën	10.000	(dhjetë mijë) lekë
2.	Vasil Mingo	në shumën	10.000	(dhyjetë mijë) lekë.
3	Dhimiter Meshini	në shumën	10.000	(dhjetë mijë) lekë
4.	Dhimo Dimçi	në shumën	10.000	(dhjetë mijë) lekë.
5.	Agron Papapano	në shumën	100.000	(njëqind mijë) lekë
6.	Irakli Proko	në shumën	10.000	(dhjetë mijë) lekë

2. Miratimin e transferimit buxhetor si më poshtë :

Pakësim në strukturën buxhetore :

GR 00, TIT AF135, KAP 01, ART 609, Kod Produkti V494AAA në shumën 150.000 lekë

Shtesa në strukturën buxhetore :

GR 00, TIT AF135, KAP 01, ART 606, Kod Produkti V494AAA në shumën 150.000 lekë

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Financës dhe Tatim –Taksa/Sektori i Buxhet Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

Përmet, më 22.08.2025

**RELACION
DREJTUAR
KËSHILLIT BASHKIAK**

Të nderuar këshilltarë!

Shtetësi Azis Ismaili banues në qytetin e Përmetit ka bërë kërkesë Nr.2448 Prot datë 31.07.2025 pranë bashkisë për tu ndihmuar financiarisht pasi është i sëmurë me diabet dhe tension e nuk i përballon dot shpenzimet për blerjen e ilaçeve të tij.

Shtetësi Vasil Mingo banues në Përmet kërkon të ndimohet financiarisht nga bashkia me kërkesë Nr.2557 Prot datë 07.08.2025 pasi është e sëmurë vetë ,pensionist,fëmijën e ka në shkollë të lartë,djalin pa punë,gruan me kemp dhe nuk i përballojnë dot shpenzimet për blerjen e ilaçeve,janë në gjendje të vështirë ekonomike si familje dhe nuk kanë asnjë burim të ardhurash,vetëm pensionin dhe kempin e gruas.

Edhe shtetësi Dhimiter Meshini banues në Përmet ka bërë kërkesë pranë bashkisë me Nr.2609 Prot datë 13.08.2025 për tu ndimuar financiarisht nga bashkia pasi ndodhet në vështirësi të mëdha ekonomike,është me probleme shëndetësore ,i vetmuar dhe nuk i përballon dot shpenzimet për blerjen e ilaçeve.

Shtetësi Dhimo Dimçi banues në fshatin Qilarisht,Përmet ka bërë kërkesë me Nr.2243 Prot datë 11.07.2025 pranë bashkisë për tu ndimuar financiarisht ,pasi nuk ka mundësi financiare për të përballuar shpenzimet, për blerjen e ilaçeve,pasi është i sëmurë.

Edhe shtetasi Agron Papapano bamues në Përmet ka bërë kërkesë Nr.2683 Prot datë 19.08.2025 pranë bashkisë për tu ndimuar financiarisht ,pasi ka kryer një ndërhyrje kirurgjikale dhe shpenzimet për kurimin e tij janë të mëdha.

Shtetasi Irakli Proko,banues në fshatin Zhepë ka bërë kërkesë Nr.2242 Prot.datë 11.07.2025 I cili kërkon të ndihmoet nga bashkia pasi është në vështirësi të mëdha ekonomike,ka bërë ndërhyrje kirurgjikale dhe shpenzimet janë të mëdha.

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ” ,Ligjin Nr. 68 /2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore ”,Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar,Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligji Nr.115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”.,VKB Nr.107 datë 18.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të

bashkisë për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj, kërkojmë që :

- | | | |
|---------------------|------------------------------------|-------------------------------|
| 1- Azis Ismaili | të ndimohet përkatësisht në shumën | 10.000 (dhjetë mijë) lekë. |
| 2- Vasil Mingo | të ndimohet përkatësisht në shumën | 10.000 (dhjetë mijë) lekë |
| 3- Dhimiter Meshini | të ndimohet përkatësisht në shumën | 10.000 (dhjetë mijë) lekë. |
| 4- Dhimo Dimçi | të ndimohet përkatësisht në shumën | 10.000 (dhjetë mijë) lekë. |
| 5- Agron Papapano | të ndimohet përkatësisht në shumën | 100.000 (njëqind mijë) lekë. |
| 6- Irakli Proko | të ndimohet përkatësisht në shumën | 10.000 (dhjetë mijë) lekë. |

Bashkengjitur i gjithë dokumentacioni përkatës.

Për Drejtorinë e Shërbimit Social

Specialisti i NE & P.A.K

Jurigen SIMONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

NR. _____, DATË. ____ . ____ / 2025

PËR NJE NDRYSHIM NE VKB NR.47 DATE 02.06.2025
PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KULTUROR DHE ARGËTUES PËR PERIUDHËN
SHTATOR – DHJETOR 2025 DHE AKORDIMIN E FONDIT PËRKATËS

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 Vetëqeverisjen vendore", Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për miratimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", bazuar në VKB 107 datë 18.12.2024 "Për buxhetin e bashkisë i ndryshuar", Vendimit nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e këshillave artistiko kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre", të ndryshuar, Udhëzimit nr.1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko-kulturor", dhe sipas Realacionit të Drejtorisë Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve.

VENDOSI:

1. Të miratojë programin kulturor dhe artistik për periudhën Shtator – Dhjetor 2025, si më poshtë:

Muzikë dhe poezi nën dritën e yjeve -50.000

Trashëgimia e gjyshërve tanë-50.000

Festa e librit "Nata poetike"-60.000

Festat e Nëntorit – 100,000 lekë

Festat e Fundvitit – 300,000 lekë



2. Të miratojë kryerjen e shpenzimeve për realizimin e aktiviteteve të mësipërme në shumën 560,000 lekë, që do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Përmet sipas VKB 107 datë 18.12.2024 i ndryshuar.
3. Ngarkohet Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

RELACION

PËR NJE NDRYSHIM NE VKB NR.47 DATE 02.06.2025
PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KULTUROR DHE ARGËTUES PËR PERIUDHËN
SHTATOR – DHJETOR 2025 DHE AKORDIMIN E FONDIT PËRKATËS

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 Vetëqeverisjen vendore", Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për miratimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", bazuar në VKB 107 datë 18.12.2024 " Për buxhetin e bashkisë i ndryshuar", Vendimit nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e këshillave artistiko kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre", të ndryshuar, Udhëzimit nr.1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko-kulturor", dhe sipas Realacionit të Drejtorisë Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve.

Për promovimin e vlerave kulturore, sociale dhe edukative në komunitet, është hartuar një program me një sërë aktiviteteve që do të shtriheshin përgjatë muajve qershor – dhjetor 2025. Aktivitetet synojnë të angazhojnë qytetarët e të gjitha moshave, veçanërisht të rinjtë dhe fëmijët, dhe të kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë sonë kulturore.

I. ARSYETIMI

Në programin e aktiviteteve kulturore të miratuar me VKB nr. 47, datë 02.06.2025, për periudhën Qershor – Dhjetor 2025, u parashikuan një sërë aktiviteteve artistiko-kulturore, përfshirë aktivitetin "Miss Albania" me vlerë 1,000,000 lekë. Shoqata "Deliart", e cila gëzon të drejtën ekskluzive për organizimin e këtij aktiviteti, paraqiti kërkesën dhe dokumentacionin përkatës pranë Bashkisë Përmet. Si rezultat, aktiviteti u realizua dhe pagesa përkatëse u krye sipas procedurave. Për këtë arsye, "Miss Albania" nuk përfshihet në programin aktual.

Duke qenë se programi kulturor nuk u realizua sipas planit, për shkak se gjatë procedurave të prokurimit operatorët ekonomikë të interesuar u tërhoqën dhe procedura mbeti pa rezultat, u bë e pamundur zhvillimi i aktiviteteve të parashikuara për muajt Qershor–Gusht 2025.



Në vijim, u mblodh Këshilli Artistik i Bashkisë Përmet, i cili, në përputhje me kompetencat e tij, vendosi që aktivitetet e parashikuara për muajt Qershor–Gusht që nuk u realizuan, të zhvillohen në periudhën Shtator – Dhjetor 2025,. Këshilli Artistik vendosi gjithashtu që fondet e mbetura prej 56,000 lekësh të rishpërndahen tek aktivitetet e muajit shtator-dhjetor, duke ruajtur fondin total të miratuar. Rritja e kostove për aktivitetet e Nëntorit dhe Dhjetorit justifikohet nga periudha festive, organizimi i veçantë për fundvit dhe pjesëmarrja e artistëve të shumtë, si dhe aktivitetet shtesë për fëmijë dhe komunitetin.

II. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Duke qenë se:

Aktivitetet nuk u realizuan për arsye objektive, të pavarura nga Bashkia;

Këshilli Artistik ka dhënë dakordësinë për zhvillimin e aktivitetve në periudhën Shtator–Dhjetor 2025 duke shtuar dhe dy aktivitet

Fondet janë të parashikuara dhe të justifikuara:

Propozohet:

Këshilli Bashkiak Përmet të miratojë ndryshimin e vendimit nr. 47, datë 02.06.2025, për realizimin e aktivitetve në periudhën shtator-dhjetor 2025, me fond të mbetur prej 56,000 lekësh, i cili do të rishpërndahet tek aktivitetet e mbetura sipas vendimit të Këshillit Artisti

II. PËRSHKRIMI I PROJEKTEVE

1. Muzikë dhe poezi nën dritën e yjeve -50.000– 19 Shtator

Qëllimi: Të nxisë dashurinë për letërsinë dhe artin nën një atmosferë relaksuese

Kosto totale: 50,000 Lekë.

Pagesa për një aktor profesionist dhe një instrumentist. Aktivitet me impakt emocional dhe kulturor për qytetarët, sidomos brezin e ri.

2. Titulli: “Trashëgimia e gjyshërve tanë”-50.000- 29 Shtator

Kosto totale 50.000

Pagesa për këngëtar. Aktiviteti ka si qëllim ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore përmes brezave dhe promovimin e artistëve përmetarë dhe i këngës tradicionale.

3. “Festa e Librit – Nata Poetike” -60.000-21 tetor

Kostot totale 60.000



Pagesa do të shkojë për blerjen e librave për nxënësit e Qendrës kulturore të Fëmijëve dhe ka si qëllim të nxisë dashurinë për librin dhe leximin tek fëmijët, të rinjtë dhe komuniteti, dhe të forcojë lidhjen mes brezave përmes fjalës së shkruar dhe artit letrar.

4. "Festat e Nëntorit" – 24-29 Nëntor

Qëllimi: Të promovojë ndjenjën e patriotizmit dhe të përkujtojë Ditën e Pavarësisë.

Kosto totale: 100,000 Lekë.

Organizimi i ekspozitave, konferencës shkencore dhe aktiviteteve teatrale me pjesëmarrjen e shkollave dhe institucioneve. Kosto e ndarë për certifikata, libra, organizim teknik.

5. "Festat e Fundvitit" – 25-31 Dhjetor

Qëllimi: Të sjellë atmosferë festive dhe t'i përfshijë fëmijët në aktivitete argëtuese.

Kosto totale: 300,000 Lekë.

III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Të gjitha projektet e paraqitura janë në përputhje me strategjinë e Bashkisë Përmet për promovimin e kulturës dhe trashëgimisë. Ato kanë impakt të drejtëpërdrejtë në komunitet dhe krijojnë një kalendar festiv të qëndrueshëm në qytet. Çdo aktivitet është i justifikuar si nga aspekti buxhetor ashtu edhe nga vlera artistike që sjell në Përmet.

Propozimi: Këshilli Bashkiak të miratojë fondin e përgjithshëm për këto projekte në shumën totale 560.000 Lekë, me ndarje sipas projekteve, siç paraqitet në këtë relacion.

PËRMBLEDHJE E VLERËS TOTALE:

Nr	Aktiviteti	Totali (Lekë)
1	Muzikë dhe poezi nën dritën e yjeve	50.000
2	Trashëgimia e gjyshërve tanë	50.000
3	festa e librit – nata poetike"	60.000
4	Festat e Nëntorit	100.000
5	Festat e Fundvitit	300.000
	TOTALI I PËRGJITHSHËM	560.000 Lekë

Konceptoi: Drejtoria e Shërbimit Social Arsim-Kulturë

Arjana Papapano